



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 945/4 prot.

Vlorë, më 23.07.2018

VENDIM

Nr. 38, datë 12.07.2018

PËR

**MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË PROGRAMIN E CIKLIT TË DYTË TË
STUDIMEVE "MASTER PROFESIONAL NË MËSUESI PËR ARSIMIN E MESËM NË
LËNDËN MATEMATIKË"**

Mbështetur në pikën 2 në nenin 83, shkronjën **dh** të pikës 1 në nenin 38 në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", shkronjën **f** të pikës 2 në kreun III të VKM-së nr. 31, datë 29.12. 2017 "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë", VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 12.07.2018

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Shkencave Teknike për ndryshime në programin e ciklit të dytë të studimeve "Master profesional në mësuesi për arsimin e mesëm në lëndën matematikë" në përshtatje me ndryshimet ligjore që parashikojnë kalimin e këtij programi studimi nga program me 90 kredite në program me 120 kredite.
2. Ky program studimi do të zbatohet për vitin akademik 2018-2019.
3. MASR do të njoftohet me shkrim për ndryshimet e bëra në këtë program studimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI

